

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EVOSS-IMPLANT" SHPK
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

NENI 1-Emërtimi i shoqërisë

Shtetasit shqiptarë:

Sabri Ilikardes i biri i Hasanit, lindur në Stamboll më 17.03.1974 me shtetësi shqiptare, dhe banues në Tiranë në adresën rr "Frederik Shiroka" Nd. 5/269 kati 5 me ID H40317229T është ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "EVOSS-IMPLANT" sh.p.k.

dhe

Recep Duran i biri i Zafer, lindur në Nurnberg Gjermani më 02/09/1972 me shtetësi shqiptare, dhe banues në Tiranë në adresën rr "Mihal Ciko" Nd. 7 Hyrja 2 me ID H20902046H është ortak i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "EVOSS-IMPLANT" sh.p.k.

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

NENI 2-Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

- Laborator dentar, klinike dentare,
- Shitje blerje te produkteve dentare
- Import – Eksport i pajisjeve mjekësore dhe pajisjeve dentare.

NENI 3-Kohëzgjatja e veprimtarisë

Shoqëria do te ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar.

Me vendim te ortakëve afati i mësipërm mund te ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

NENI 4-Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakët.

NENI 5 -Selia e shoqërisë

Shoqëria "EVOSS-IMPLANT" Sh.p.k ka qendrën në Tiranë Njësia Bashkiake nr. 9, Rruga Mine

Recep Duran
[Signature]

SABRI IKILARDES
[Signature]

Peza, Pallati nr. 196, Shk. 2, Ap. 10, Kati 1 dhe do te ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 6- Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i Ortakëve.

Kapitali është i ndare në 2 kuota me vlere nga 50.000 lekë (pesëdhjetë mijë lekë) secila respektivisht:

1. Sabri Ikikardes Ortak me 50% te kapitalit te shoqërisë zotëron 1 kuotë ne vlerën 50.000 lekë.
2. Recep Duran Ortak me 50% te kapitalit te shoqërisë zotëron 1 kuotë ne vlerën 50.000 lekë.

Kapitali i shoqërisë mund te rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakëve.

NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat qe rrjedhin prej tyre me vendim të ortakëve mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakët ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
- d) çdo mënyre tjetër te parashikuar me ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

3. Ne rastin kur njeri nga ortakët vendos te largohet fillimisht i bën ofertën Ortakut ose Ortakeve te tjerë te Shoqërisë e më pas personave te tjerë.

NENI 8—Ortakët e Shoqërisë

Shoqëria zotërohet nga dy ortakë me nga 50% te kapitalit dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga të dy ortakët. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë se

Recep Duran


SABRI IKIKARDES


veprimtarisë;

- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

NENI 9 – Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "EVOSS-IMPLANT" sh.p.k do drejtohet nga dy administratorë me të drejta të plota dhe të barabarta që emërohen me vendim të ortakëve.

Administratorë të Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim (18/04/2018 deri 17/04/2023) do të jenë vetë ortakët e Shoqërisë z Sabri Ilikardes dhe z Recep Duran

9.2 Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ortakëve;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakëve për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;


9.3 Ortakët mund ta shkarkojnë administratorin/rët në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit/ve, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

9.4. Administratorët do shpërblehen sipas përcaktimit të ortakëve në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008.

9.5 Administratorët kanë të drejtë të caktojnë dhe revokojnë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tyre.

Recep Duran


SABRI ILIKARDES


NENI 10-Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakëve të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakëve të saj.

NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortakët vendosin mbi mënyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratorët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".


NENI 13- Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKET e Shoqërisë.

Shoqëria "EVOSS-IMPLANT" SHPK do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti.

Ky statut nënshkruhet prej ortakëve në datë 18/04/2018.

ORTAKET E SHOQERISE

Recep Duran


SABRI IKILARDES
